

VENDIM
Nr.914, datë 29.12.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.808, DATË 5.11.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MBAJTJEN DHE MENAXHIMIN E REZERVËS SË SIGURISË PËR
NAFTËN, GAZIN DHE NËNPRODUKTET E TYRE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paragrafi i parë i shkronjës “b” të pikës 3 të kreut I të vendimit nr.808, datë 5.11.2004 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Sasia e rezervës së sigurisë, që do të depozitohet nga subjektet, të cilat kanë detyrimin për ta mbajtur këtë rezervë sigurie, është:

- i) jo më pak se 30 për qind në depozitat e vetë subjektit, të cilat janë të certifikuara teknikisht;
- ii) jo më shumë se 40 për qind në depozitat e certifikuara teknikisht të subjekteve, me të cilat subjekti, që ka detyrimin për të mbajtur rezervën e sigurisë, ka lidhur marrëveshje kontraktore.

Në rastin e marrëveshjeve kontraktore me subjektet e shitjes me pakicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, për furnizim ekskluziv, sasia e rezervës së sigurisë do të llogaritet për jo më shumë se dy subjekte të tregtimit me pakicë.

Rezervë sigurie për subjektin llogariten edhe sasi të kontraktuara e të likuiduara, por jo më shumë se 30 për qind e sasisë së rezervës së sigurisë së llogaritur, të vërtetuar me kontratat e nënshkruara dhe faturat përkatëse, për likuidimin e sasive të kërkuara.”.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha